

VENDIM
Nr. 74, datë 2.12.2020

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARIVE FINANCIARE SHITESË NGA BANKA CREDINS SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpikat “iii”, “vi” dhe “vii”, nenit 54, pika 2, shkronjat “e” dhe “ë” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Credins sh.a. të veprimtarive financiare shitesë të:

- a) marrjes së angazhimeve;
- b) tregtimit për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i. produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (*futures*) dhe kontrata me opsione (*options*);
 - ii. instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare;
 - iii. pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;
- c) ndërmjetësimit për transaksionet monetare të mëposhtme:
 - i. administrimin e aktiveve të tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve;
 - ii. shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;
 - iii. sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar, si dhe përpunimin e të dhënave financiare e të programeve që kanë lidhje me të, nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare;
- d) shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimeve të tjera ndihmëse, për:
 - i. ndërmjetësimin për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit,
 - ii. tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe për veprimet me arin;
 - iii. tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme;
 - iv. të gjitha veprimtaritë e listuara në shkronjat “a” deri “c” më sipër, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Credins sh.a.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko